

# RAPORTI I PERFORMANCËS

## VITI 2019

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim  
Rr. Milto Tutulani, Nd. 6, Hyrja 8/3 & 4 1019, Tirana, Albania  
T/F: +355 4 2203054 | [info@cdinstitute.eu](mailto:info@cdinstitute.eu) | [www.cdinstitute.eu](http://www.cdinstitute.eu) | Twitter/Facebook: @cdialbania



## RAPORTI I PERFORMANCËS

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim

Periudha: 1 Janar 2019 – 31 Dhjetor 2019

## I. Objektivat dhe aktivitetet

### I.1. Qëllimi/et e themelimit

Statuti parashikon që veprimtaria e Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI) të përqëndrohet në fushat e mëposhtme:

- Ndërmarrjen e iniciativave dhe aktiviteteve të bashkëpunimit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, të eksperiencave dhe njohurive midis institucioneve, organizatave, studiuesve dhe ekspertëve vendas dhe të huaj;
- Përgatitjen e studimeve, strategjive, dhe programeve për zhvillimin e sektorëve specifike të ekonomisë apo për çështje të rëndësishme të zhvillimit ekonomik e social të vendit;
- konceptimin dhe zbatimin e projekteve konkrete me karakter ekonomik dhe social;
- Studimin dhe rekomandimin e përmirësimeve të legjislacionit në fuqi apo përgatitjen e projekt-akteve të reja ligjore në përputhje me studimet e ndermarra;
- Mbështetjen dhe asistimin e aktivitetit të institucioneve lokale në drejtim të politikave të zhvillimit rajonal duke u ofruar atyre materiale me karakter studimor, informativ dhe dokumentar;
- Përgatitjen e strategjive dhe zbatimin e tyre me synim formimin dhe përgatitjen e kualifikuar të burimeve të reja njerëzore;
- Botimin e publikimeve me karakter informues, studimor dhe promovues për sa më sipër;
- Mbështetjen dhe promovimin e potencialeve intelektuale vendase e të huaja për realizimin e drejtimeve të mësipërme etj.
- Implementimin e programeve dhe projekteve që synojnë intergimin e Shqipërisë në BE.

Konform Statutit, CDI ka zhvilluar tre fusha programatike në të cilat strukturon aktivitetet e saj:

1. BE dhe Konektiviteti
2. Mirë-qeverisja
3. Rinia dhe Shoqëria

### I.2. Aktivitetet kryesore të ndërmarra në lidhje me qëllimin/et;

Gjatë vitit 2019, CDI ka vijuar me zhvillimin e aktiviteteve të saj në dy modalitete kryesore: i) iniciativa kryesore të vazhdueshme (*flagship*); dhe, ii) projektet sipas 3 fushave programatike.

Në kuadër të iniciativave kryesore të vazhdueshme mund të përmendim:

- Edicionin e V të Tirana Connectivity Forum
- Western Balkans Youth Cooperation Platform
- Shtetiweb

Në kuadër të projekteve kryesore të zbatuara në vitin 2019 mund të përmendim aktivitete kryesore si:

- South-Adriatic Connectivity Governance
- Preparing and Supporting Albania for EU Accession Process
- Applying Sector Approach to Civil Society Contribution in EU Integration of Albania
- Ports as Driving Wheels of Entrepreneurial Realm

### I.3. Mënyra e punës direkte apo nëpërmjet OJF-ve më të vogla;

CDI vepron e pavarur dhe manaxhon aktivitetet direkt në perputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me bazën ligjore të kontratave për projektet e ndryshme që zbaton.

CDI vepron në partneritet me OJF vendore si-motra, dhe me partnerë në Ballkan dhe në Bashkimin Evropian.

## II. Arritjet dhe performanca

Gjatë 2019, CDI ka organizuar mes të tjerash:

- Tirana Connectivity Forum 2019;
- Publikuar tetë Policy Papers/raporte;
- Ka marrë pjesë në nëntë evente të nivelit shumë të lartë rajonal dhe ndërkombëtar, përfshirë dhe Samitin e Ballkanit Perëndimor në Poznan;
- Organizuar/bashkë-organizuar 55 evente (19 jashë Shqipërisë, 36 në Shqipëri);
- Ka kontribuar në KKIE si anëtar; ka dhënë kontributin në përgatitjen e Plani i ri i Veprimit Anti-korrupsion 2020-2023; ka kontribuar me dalje mediatike duke informuar publikun mbi dinamikat e procesit të Zgjerimit.
- Etj.

## III. Raportimi Financiar

### III.1. Arritjet në gjetjen e burimeve të financimit

CDI përpilon buxhetin për projektet gjatë aplikimeve direkte apo pjesëmarrjes në thirrje për grante nga donatorët.

*Turnover* i CDI për vitin 2019 ishte: 51,6 milion Lekë

Shpenzimet për vitin 2019 klasifikohen si më poshtë:

- financuar nga fonde të BE:	54%
- financuar nga institucione të vendeve të tjera:	33%
- financuar nga të tjera:	13%

III.2. Mirëpërdorimi i burimeve direkte nga OJF-ja apo organizatat të cilave i ka akorduar fonde (si shoqëri mëmë, p.sh);

CDI zbaton Standartin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse për mbajtjen e të dhënave dhe përgatitjen e pasqyrave financiare. Organizata mund të përdorë një sistem të vecantë raportimi nëse kjo kërkohet nga donatorët.

CDI pranon të hyra nga Donatorët vetëm në llogaritë bankare të Institutit. Nënlligari të veçanta bankare hapen vetëm nëse kërkohet nga një donator specifik për aktivitete / projekte specifike, dhe nëse CDI ka rol Koordinator/*Lead* të projektit.

CDI paguan të gjitha tatimet dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi.

CDI përpilon pasqyrat financiare vjetore për Administratën Tatimore. Auditimi i pasqyrave financiare vjetore kryhet nga një kompani auditimi e jashtme.

Pagesat bëhen me transaksione bankare, me përjashtim të pagesave të vogla<sup>1</sup> të cilat kryhen nga arka.

Pagesat kryhen sipas stadeve të procedurës respektive, në bashkëpunim me stafin mbështetës, autorizohen nga Drejtori Ekzekutiv dhe kryhen nga Financieri.

#### IV. Struktura, drejtimi dhe raportimi

##### IV.1. Të dhëna identifikuese për OJF-në (selia, numri i regjistrimit, NIPT-i, etj);

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim është themeluar në vitin 2000 pranë Gjykatës Tiranë dhe ka nr. Rregjistrimi 709/5. NIPT-i i organizatës është: L11523451E. Selia e organizatës ndodhet në adresën: Rr. Milto Tutulani Nd. 6, Hyrja 8/ 3 & 4, Tiranë.

IV.2. Struktura organizative e OJF-së; ku sipas objektivave dhe politikave të donatorëve e përfituesve, mund të përmenden

Sipas vendimit nr. 709/4 dt. 19.01.2016, Bordi Drejtues i CDI përbëhet nga Bordi prej tre anëtarësh. Bordi ka emëruar drejtorin aktual me vendim 709/3 dt. 25.05.2011.

Në përputhje me statutin dhe legjislacionin në fuqi Drejtori Ekzekutiv kryen përfaqësimin e CDI pranë palëve të treta, është autoritet nënshkrues për kontratat e stafit, ato të projekteve dhe bashkëpunimeve të ndryshme, raportimeve financiare, etj. sipas dispozitave përkatëse.

Me konsolidimin e organizatës, rritjes së profesionalitetit dhe reputacionit të saj në rang kombëtar, rajonal dhe evropian, është krijuar dhe struktura kërkimore shkencore. Drejtori i Kërkimit koordinon dhe zhvillon komponentin kërkimor të aktiviteteve, duke bashkëpunuar me stafin dhe ekspertizën e jashtme.

---

<sup>1</sup> Konform legjislacionit shqiptar në fuqi për pagesat *cash*.

CDI ka në përbërje të stafit burime njerëzore *senior* dhe *junior*. Organizata zbaton aktivitetet duke angazhuar fillimisht stafin e brendshëm sipas specializimeve të tij, dhe kur e nevojshme plotëson nevojat e aktiviteteve nëpërmjet kontraktimit të ekspertëve të jashtëm.

Stafi i brendshëm ka kompetenca:

- a) manaxheriale projektsh,
- b) koordinimi programesh e projektsh,
- c) ndihmesë në zbatimin e projekteve,
- d) hulumtimi sipas fushave, dhe
- e) operacionale e logjistike.

Përgjithësisht vendimarrja mbi produktet me komponent hulumtues, merret nga Drejtori i Kërkimit me aprovim nga Drejtori Ekzekutiv, bazuar në propozimet e ekipit që ka punuar për ato produkte. Vendimarrja për aspektet administrative / financiare merret nga Financieri dhe/ose Drejtori Ekzekutiv. Për produktin "Rekrutime", vendimarrja i takon Drejtorit Ekzekutiv, bazuar në procedurat përkatëse të përzgjedhjes dhe / ose sipas bazës ligjore të projekteve të ndryshme.

Drejtori Ekzekutiv prezanton në baza vjetore raportin e punës në Bord, duke përfshirë anën financiare, anën përmbajtësore dhe të tjera.

#### IV.4 Me OJF-së me organizata të tjera

CDI bashkëpunon ngushtë me organizata të tjera në vend, rajon dhe më gjerë. Bashkëpunimi bazohet në iniciativa dhe projekte të vecanta, në kuadër të zhvillimit dhe zbatimit të të cilave zhvillohet edhe marrëdhënia e partneritetit dhe bashkëpunimit. Një partneritet të ngushtë CDI ka ndërtuar ndër vite me Kongresin Rinor Shqiptar, me të cilin ka bashkëpunim në mënyrë sistematike në kuadër të dy programeve të saj, "Rinia dhe Shoqëria" dhe "BE dhe Konektiviteti".

#### V. Të tjera me interes nga OJF për t'u paraqitur

CDI është anëtar i Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian (KKIE) prej vitit 2016, i Komitetit Koordinator kundër Korrupsionit, i Tryezës së Diskutimit dhe Këshillimit për Kapitullin 22 të Negociatave për Zgjerim.